

KËRKESE
Nr. 1681/4, datë 20.7.2018

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Brendshme shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i rrugës paralel me murin rrethues të Portit”, në Bashkinë Durrës.

Subjekti kërkesës është Bashkia e Durrësit. Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët do të likuidohen, për efekt shpronësimi, me paraqitjen e dokumenteve të rregullta të pronësisë, pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave, që do të miratojë kërkesën për shpronësim. Vlera totale e shpronësimit është 708.750 (shtatëqind e tetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I BRENDSHËM
Romina Kuko

TABELA PËRMBLEDHËSE E VLERËSIMIT TË SHPRONËSIMIT PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE TË CILAT PREKEN NGA OBJEKTI: "NDËRTIMI I RRUGËS PARALEL ME MURIN RRETHUES TË PORTIT, BASHKIA DURRËS

Nr.	Emër, mbiemër	Zona kadastrale	Nr. pasurie	Sip. e objektit që shpronësohet m ²	Çmimi i ndërtesës për m ²	Vlera e përgjithshme në lekë	Nr. i shkresës së konfirmimit nga ZVRPP-ja Durrës
1	Mikel Asti Pepa	8514	4/418/N D-G	15	67500 x 0.7 = 47250	708750	1804/1, datë 16.3.2018

TOTALI

708750